

V E N D I M
Nr.295, datë 8.5.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS MESATARE TË
VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË
PENSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koeficientët për indeksimin e bazës mesatare të vlerësimit vjetor, individual, që personat e siguruar e kanë realizuar nëpërmjet pagimit të kontributeve, për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për Vitin	2002	1
Për Vitin	2001	1.14
Për Vitin	2000	1.07
Për Vitin	1999	1.09
Për Vitin	1998	1.05
Për Vitin	1997	1.22
Për Vitin	1996	1.09
Për Vitin	1995	1.37
Për Vitin	1994	1.32

2. Efektet financiare, që lidhen në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.258, datë 13.6.2002 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual për llogaritjen fillestare të pensionit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano